

Afet Mamuti, PhD¹

UDC: 364.63-027.553:340.13
364.63-027.553:341.24

**PERSPEKTIVAT LIGJORE NDËRKOMBËTARE DHE
KOMBËTARE PËR DHUNËN NË FAMILJE**

**МЕЃУНАРОДНИ И НАЦИОНАЛНИ ПРАВНИ
ПЕРСПЕКТИВИ ЗА СЕМЕЈНО НАСИЛСТВО**

**INTERNATIONAL AND NATIONAL LEGAL PERSPECTIVES ON
DOMESTIC VIOLENCE**

Abstract

Personal integrity is a right that encompasses the physical, mental and moral spheres of an individual. Violation of any of these values constitutes an encroachment or violation of the right of the individual. When this violence occurs between members who are in a family relationship, then it qualifies as domestic violence. Domestic violence is the behavior of a family member who by his actions or inaction endangers the physical integrity, mental health or well-being of another family member. Domestic violence is a term that usually refers to violence between spouses, parents and children as well as other relative persons. Domestic violence is a phenomenon present in all countries of the world and in all civilizations, regardless of cultural, religious, racial, gender, ethnic, social or political differences. The legal approach to this phenomenon differs from one country to another. Countries with more developed democracies have much earlier sanctioned this phenomenon with legal norms in criminal and civil terms much earlier. Even at the international level, the phenomenon of domestic violence has been and

¹ Faculty of Law, University of Tetova, Republic of Macedonia. Email: afet.mamuti@unite.edu.mk

is a matter of debate by many regional and universal organizations, starting with the UN, the European Union, the Council of Europe, etc. Regarding this, legal acts have been adopted for the protection of victims of domestic violence, which have subsequently been ratified and have become part of national rights. The national legal framework in the Republic of North Macedonia in this area is rich in normative solutions in both civil and criminal legislation. All these rules provide for concrete institutional actions for state bodies, in terms of preventing the occurrence of violence, protecting victims of domestic violence and sanctioning the perpetrator. Contemporary trends aim to increase the focus of state institutions, non-governmental organizations and civil society in eliminating the causes of the domestic violence.

Keywords: *domestic violence, legal framework, prevention, legal protection, victims of violence*

Standardet minimale dhe të kuptuarit e dhunës në familje

Të gjithë njerëzit si pjesëtar të familjes, burra dhe gra, kanë të drejtën për vetveten dhe për fëmijët e tyre që t'i rrisin pa dhunë dhe me dinjitet. Rritja e vetëdijes dhe ngritja e nivelit të arsimit të shoqërisë, pa mëdyshje që ngrit standardin e të kuptuarit të të drejtave të individit, që reflektohet edhe në mbrojtjen dhe parandalimin e shkakimit të dukurisë së dhunës në familje. Katërmbëdhjetë vjet më parë, përmes Deklaratës për Eliminimin e Dhunës ndaj grave, Kombet e Bashkuara u bënë thirrje shteteve të sigurojnë “nivelet maksimale të mundshme në kuadër të burimeve të tyre që kanë në dispozicion, dhe aty ku nevojitet, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, kur ato gra që i nënshtrohen dhunës dhe fëmijët e tyre, kur është e nevojshme, të kenë ndihmën e specializuar”.

Dhuna në familje paraqet dukuri të rrezikshme shoqërore të cilës duhet kushtuar vëmendje e veçantë. Rreziku i saj qëndron në faktin se ajo ndodh brenda familjes, prapa mureve apo dyerve të mbyllura dhe shumë vështirë kuptohet apo deklarohet.

Dhuna në familje godet të gjitha shtresat e shoqërisë, pavarësisht nga gjinia, mosha, përkatësia fetare, racore apo nacionale. Prezenca e dhunës në familje ka rol mjaft negativ, pasi i prish marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të familjes, që mund të sjell pasoja edhe psikike, të cilat mund të zgjasin për kohë më të gjatë.

Dhuna në familje mund të jetë e natyrave të ndryshme, dhe e njëjta mund të jetë si dhunë fizike, psikike, seksuale apo ekonomike.

Por zakonisht, dhuna në familje shfaqet si kombinim i më shumë formave njëkohësisht. Kështu p.sh., kur kemi të bëjmë me dhunën seksuale, ajo zakonisht përcillet edhe me dhunë fizike dhe emocionale.

Si viktimë e dhunës në familje mund të jetë çdo anëtar i familjes. Por praktika ka dëshmuar që në rastet më të shpeshta si viktima paraqiten gratë dhe fëmijët. Kjo vjen edhe për shkak të natyrës më të dobët fizike të tyre edhe si rezultat i botëkuptimeve sociale që kanë lëshuar rrënjë të thella dhe që vështirë ndryshohet.

Këto bindje sociale, kulturore, juridike dhe tradicionale që janë krijuar dhe janë forcuar përgjatë historisë, përfshirë edhe qëndrimet për dhunën në familje edhe përkundër përpjekjeve për eliminimin e tyre, të njëjtat akoma janë prezentë.

Në nivel global viktima të dhunës në familje janë kryesisht gratë. Kjo shihet edhe në bazë të rezultateve të publikuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, në shkurt të 2022, sipas të cilës “Më shumë se 1 në 4 gra në botë kanë përjetuar dhunë në familje gjatë jetës së tyre”. Në disa vende, dhuna në familje ende konsiderohet si diçka legjitime, madje për dhunuesin duket edhe si diçka e ligjshme, veçanërisht nëse ekziston tradhtia bashkëshortore apo dyshimi për të nga ana e burrit. Disa hulumtime kanë treguar se ekziston një korrelacion i drejtpërdrejtë dhe i rëndësishëm ndërmjet shkallës së pabarazisë gjinore në një vend dhe prezencës së dhunës në familje.

Dhuna ndaj grave nënkupton cenimin e të drejtave të njeriut të gruas, sikurse: të drejtën për jetë, për siguri, për dinjitet, për integritet fizik dhe moral dhe si forma e dhunës e bazuar në gjini. Është e pranuar përgjithësisht se dhuna e privon gruan nga mundësia që t’i gëzojë liritë fundamentale njerëzore dhe paraqet pengesë serioze për barazi ndërmjet grave dhe burrave.

Korniza juridike ndërkombëtare për dhunën në familje

Nëse do të bëjmë një analizë të legjislacionit pozitiv, do të vërejmë se aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë dhe ligjet e sjella nga Parlamenti për pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, parashohin një sërë veprimesh të ndërlydhura dhe koordinuara të organeve shtetërore dhe OJQ-ve për të parandaluar dhunën në familje dhe për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje. Problemi kryesor sot e kësaj dite vazhdon të ngelet dallimi ndërmjet barazisë juridike dhe asaj faktike ndërmjet anëtarëve të familjes.

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut,² në preambulë përmban dispozita të rëndësishme për të kuptuarit e barazisë gjinore, respektivisht faktin që gratë dhe burrat kanë të drejta të barabarta nga njëra anë, kurse në anën tjetër, dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje vazhdon të ngelet prezent si një formë e mohimit të dinjitetit të lindur dhe të drejtave të barabarta të patjetërsueshme të të gjithë njerëzve. Deklarata Universale e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në Francë në vitin 1948 dhe është dokumenti bazë dhe ndoshta më i rëndësishëm ndërkombëtar në këtë fushë, e cila shërben dhe si prelude i shumë dokumenteve tjera që lidhen me fusha specifike të të drejtave të njeriut. Shikuar historikisht, ky dokument është modeluar nga “Deklarata Franceze e të Drejtave të Gruas dhe të Qytetares” të vitit 1789 dhe “Kartës Amerikane të të Drejtave” të vitit 1791.

Në kuadër të Këshillit të Evropës, dokumenti më i rëndësishëm për të drejtat e njeriut u krijua në vitin 1950, **Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ).**³ KEDNJ ka hyrë në fuqi në vitin 1953. Teksti i KEDNJ është një recipim “rajonal” i parimeve kryesore që përmban Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe është revolucionar në llojin e tij. Është një instrument i fuqishëm që u mundëson shteteve anëtare të mbrojnë dhe garantojnë të drejtat e njeriut, të çdo personi nën juridiksionin e tyre. KEDNJ synon t’u sigurojë shteteve anëtare: të drejtat themelore të njeriut; mbrojtjen e lirisë personale; garantimi e sundimit të së drejtës; të drejtat e veçanta për liri dhe të drejtën për martesë dhe familje.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR)⁴ është një marrëveshje shumëpalëshe e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. Rezoluta 2200A (XXI) e 16 dhjetorit 1966 hyri në fuqi më 23 mars 1976 në përputhje me nenin 49 të Paktit. Neni 49 lejon që pakti të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tridhjetë e pestë për ratifikim ose aderim. Pakti i obligon anëtarët e tij të respektojnë të drejtat civile dhe politike të individëve, duke përfshirë të drejtën për jetë, liri dhe fe, lirinë e fjalës, lirinë e tubimit, të drejtën e votës dhe të drejtën për një gjykim të drejtë.

² United Nations. (1948). *Universal Declaration of Human Rights*.

³ Council of Europe. (1950). *Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms*. In *Council of Europe Treaty Series 005*. Council of Europe

⁴ United Nations (General Assembly). (1966). *International Covenant on Civil and Political Rights*. *Treaty Series*, 999, 171

Që nga shtatori 2019, Pakti ka 173 anëtarë dhe gjashtë nënshkrues të tjerë që nuk e kanë ratifikuar. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike është pjesë e Kartës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, së bashku me Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (ICESCR) dhe Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (UDHR). Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike mbikëqyret nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (organ i veçantë i Këshillit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut), i cili shqyrton raportet e rregullta të shteteve nënshkruese për zbatimin e të drejtave. Shtetet duhet të raportojnë fillimisht pas një viti pas aderimit në Pakt dhe më pas sa herë që Komiteti e kërkon këtë (zakonisht çdo katër vjet). Komiteti si rregull mblidhet në Gjenevë dhe zakonisht mban tre takime në vit.

Në vitin 1967, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi **Deklaratën për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave**,⁵ duke shprehur shqetësimin se pavarësisht progresit në të drejtat e njeriut, diskriminimi i konsiderueshëm ndaj grave vazhdoi. Deklarata edhe pse ka karakter jo-detyrues, e njëjta hodhi themelet për **Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave**.⁶ Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave u miratua në vitin 1979 në Nju Jork dhe konsiderohet si një dokument themelor në luftën kundër diskriminimit ndaj grave.

Komiteti për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave në vitin 1989 trajtoi për herë të parë e adresoi dhunën ndaj grave me miratimin e **Rekomandimit të Përgjithshëm nr. 12**.⁷ Disa vite më vonë, në vitin 1992, Komiteti miratoi **Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 19**,⁸ i cili ofron një pasqyrë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të asaj që përbën dhunë me bazë gjinore dhe ajo çfarë në

⁵ 2263 (XXII). Declaration on the Elimination of Discrimination against Women, http://www.eods.eu/library/UNGA_Declaration%20Women_1967_en.pdf

⁶ Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women New York, 18 December 1979, <https://web.archive.org/web/20150507222247/http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CEDAW.aspx>

⁷ GENERAL RECOMMENDATIONS ADOPTED BY THE COMMITTEE ON THE ELIMINATION OF DISCRIMINATION AGAINST WOMEN, Eighth session (1989)*, General recommendation No. 12: Violence against women, <https://www.ohchr.org/en/hrbodies/cedaw/pages/recommendations.aspx>

⁸ GENERAL RECOMMENDATIONS ADOPTED BY THE COMMITTEE ON THE ELIMINATION OF DISCRIMINATION AGAINST WOMEN, Eleventh

fakt, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit parashikon si një detyrim për shtetet që të sigurojnë mbrojtjen e duhur për viktimat. Ky rekomandim është në fakt një katalizator për ndryshimet në legjisllacionin e shteteve anëtare, duke ngritur kështu standardin për mbrojtjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore në nivel ndërkombëtar në dekadat e fundit. Në periudhën në vijim, pasuan një sërë dokumentesh të rëndësishme që dënojnë dhunën me bazë gjinore dhe qartësojnë standardet për eliminimin e kësaj lloji dhune dhe detyrimet e shteteve që duhet të marrin në atë drejtim.

Në seancën e saj të 85-të plenare në dhjetor 1993, Kombet e Bashkuara miratuan **Deklaratën për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave (A / RES / 48/104)** si instrumentin e parë ndërkombëtar që trajton këtë çështje, duke theksuar urgjencën në zbatimin e përgjithshëm të të drejtave dhe parimeve për mbrojtjen e të drejtave të grave, në lidhje me barazinë, sigurinë, lirinë, integritetin dhe dinjitetin e të gjitha grave si qenie njerëzore. Deklarata pohon se dhuna ndaj grave është shprehje e disbalancimit gjinor, dhe se ajo cenon dhe rrezikon të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, pengon zhvillimin e plotë dhe i mban gratë dhunshëm në pozitë varësie permanente. Deri në vitin 1993, asnjë dokument ndërkombëtar nuk e trajtonte çështjen e dhunës ndaj grave si temë më vete. Deklarata për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 1993 dhe e cila konsiderohet si rezultat i Konferencës Botërore të OKB-së për të Drejtat e Njeriut në Vjenë, shënoi një hap historik përpara. Falë kësaj deklaratë, temës së dhunës në familje apo dhunës ndaj grave iu kushtua më shumë vëmendje, dhe në nivel ndërkombëtar disa vende filluan të shfaqin interes më të madh për këtë çështje.

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve⁹ u miratua me Rezolutën 44/25 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në vitin 1989. Vetë Konventa, si një nga instrumentet bazë të së drejtës ndërkombëtare, bazohet në katër parime themelore, duke theksuar: të drejtën për jetë; angazhimin për mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijës dhe detyrimin për mosdiskriminim; mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës dhe respektimin e pikëpamjeve të fëmijës. Megjithëse dokumenti nuk trajton drejtpërdrejt çështjen e dhunës në familje, shqyrtimi i Konventës është i

session (1992)**; General recommendation No. 19: Violence against women, <https://www.ohchr.org/en/hrbodies/cedaw/pages/recommendations.aspx>

⁹ https://treaties.un.org/doc/Treaties/1990/09/19900902%2003-14%20AM/Ch_IV_11p.pdf

një rëndësie të veçantë duke pasur parasysh ndikimin e vazhdueshëm që viktimizimi i fëmijës ka drejtpërdrejt ose indirekt tek më të rinjtë.

Duke iu referuar parimeve të shpallura nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Preambula e Konventës konfirmon njohjen e dinjitetit të fëmijës dhe të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të bashkësisë njerëzore. Megjithatë, duke iu referuar të njëjtin dokument, aty theksohet se fëmijëve në fëmijëri duhet kushtuar kujdes dhe ndihmë e veçantë dhe se familjes si një njësi themelore e shoqërisë duhet t'i sigurohet mbrojtje e nevojshme, që të mund të marrë plotësisht përgjegjësi dhe të përmbushë detyrimet e saj, në kontekstin e zhvillimit dhe mirëqenies së të gjithë anëtarëve të saj. Në këtë kuptim, theksohet veçanërisht se fëmija, që të zhvillojë plotësisht dhe në mënyrë harmonike personalitetin e tij, duhet të rritet në një mjedis familjar, në atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi.

Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim,¹⁰ janë të një rëndësie të veçantë në literaturën shkencore si dokumente të miratuara në Konventën e katërt botërore të mbajtur në vitin 1995, në pesëdhjetëvjetorin e themelimit të Kombeve të Bashkuara. Këto dokumente theksojnë synimin e vendeve nënshkruese për të arritur dhe promovuar barazinë, zhvillimin dhe paqen në të mirë të të gjitha grave në botë dhe në interes të mbarë njerëzimit. Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim trajton çështjen e zgjerimit të të drejtave të grave dhe synon heqjen e barrierave në të gjitha fushat e jetës publike dhe private, në arsim, në shëndetësi, në vendimmarrje dhe pushtet, eliminimin e pabarazisë ekonomike, në sigurinë institucionale, në zhdukje të varfërisë, në eliminim të dhunës dhe të tjera.

Çështja e dhunës ndaj grave tashmë po diskutohet dhe është temë debati në qarqe të ndryshme institucionale, shkencore dhe OJQ. Në këtë drejtim janë mediat ato që kanë një ndikim të madh në shpërndarjen e informacionit me qëllim të parandalimit të dukurisë së dhunës në familje. Në këtë kontekst, neni 77 rekomandon që të rinjve t'u jepen aftësi kritike dhe analitike, pasi fuqia e medias nuk është vetëm në shpërndarjen e informacionit pozitiv, por mund të ndikojë negativisht në zhvillimin e vlerave, qëndrimeve dhe perceptimeve ndaj grave. Kjo qasje ka ndryshuar për mirë në shumë vende ku gratë janë përfshirë në politikë. Përmirësim ka edhe në fushën e arsimit, veçanërisht në vendet

¹⁰ United Nations, Beijing Declaration and Platform of Action, adopted at the Fourth World Conference on Women, 27 October 1995, available at: <https://www.refworld.org/docid/3dde04324.html>

ku arsimi ishte i ulët. Parimet e Deklaratës së Pekinit dhe Platforma për Veprim duhet të ndiqen më tej dhe të forcohet bashkëpunimi ndërkombëtar. Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim synon të heqë pengesat për pjesëmarrjen e plotë të grave në jetën publike dhe private dhe se e njëjta konsiderohet një nga dokumentet më gjithëpërfshirës të OKB-së në fushën e barazisë midis grave dhe burrave.

Deklarata e Mijëvjeçarit¹¹ është një dokument i miratuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 2000 në Samitin e mijëvjeçarit në Nju Jork nga liderët e 189 shteteve anëtare të OKB-së. Vetë Deklarata është një dokument kompleks që trajton një sërë çështjesh, duke përfshirë nevojën për të mbështetur përpjekjet për të respektuar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore dhe për të respektuar të drejtat e barabarta të të gjithë njerëzve, pavarësisht nga raca, gjinia, gjuha apo feja. Kështu, ndër vlerat themelore më të rëndësishme për marrëdhëniet ndërkombëtare në shekullin e 21-të, janë çështja e lirisë; e drejta e burrave dhe grave për të jetuar jetën dhe për të rritur fëmijët me dinjitet, pa frikë nga dhuna, shtypja apo padrejtësi; barazia dhe parimi që asnjë individ dhe asnjë grupi nuk mund t'i mohohet apo diskriminohet nga çfarëdo baze të garantuar nga aktet ndërkombëtare. Shtetet duhet të udhëhiqen nga solidariteti për të shpërndarë shpenzimet dhe përgjegjësitë në mënyrë të drejtë në përputhje me parimet bazë të barazisë dhe drejtësisë sociale, duke ua lehtësuar kushtet atyre që vuajnë ose fitojnë më pak dhe duke obliguar ata që përfitojnë më shumë. Ky dokument po ashtu parasheh edhe tolerancën dhe respektin për diversitetin e besimeve, kulturave dhe gjuhëve.

Rëndësia e Deklaratës në kontekstin e dhunës në familje theksohet gjithashtu në Pjesën III, 20, e cila promovon barazinë gjinore dhe të drejtat e grave si një formë efektive për të luftuar varfërinë, urinë dhe sëmundjet dhe zhvillimin real të qëndrueshëm. I njëjti kontekst theksohet në Pjesën V, 20, e cila thekson respektimin dhe mbështetjen e plotë të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, si dhe ndjekjen e mbrojtjes dhe promovimit të plotë të të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore për të gjithë dhe në të gjitha vendet. Udhëheqësit i kushtuan vëmendje të veçantë aspiratave për zbatimin e plotë të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, si një mënyrë për të luftuar të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, si dhe ratifikimin dhe zbatimin e plotë të Konventës për Të drejtat e fëmijës dhe protokollat e saj

¹¹ Millennium Development Goals (MDGs), United Nations, 1990

jodetyruese në lidhje me konfliktet, trafikimin e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve.

Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje - Konventa e Stambollit¹² është deri tani dokumenti më gjithëpërfshirës ndërkombëtar që merret me shkeljet e të drejtave të njeriut dhe që njeh zero tolerancë për dhunën ndaj grave dhe i pari që trajton në mënyrë specifike çështjet familjare dhe dhunën me bazë gjinore.

Konventa e Stambollit identifikoi aspekte të tilla si dhunën si shkelje e të drejtave të njeriut dhe format e diskriminimit, përkufizimet për vepra penale të caktuara, sikurse përndjekjen, që shtetet anëtare duhet me patjetër t'i përfshijnë në sistemet e tyre ligjore. Konventa ofron gjithashtu edhe një pasqyrë të krimeve, të cilat përfshijnë maltretimin fizik, abuzimin mendor, ngacmimin dhe dhunën seksuale. Si marrëveshje e parë ndërkombëtare, ajo përmban një përkufizim të gjinisë, jo vetëm si dallim biologjik midis burrave dhe grave, por edhe rolet dhe sjelljet e tyre specifike në shoqëri.

Konventa e Stambollit përmban një sërë përkufizimesh, duke përcaktuar, ndër të tjera, dhunën në familje si “çdo veprim dhune fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodh në familje ose në shtëpi ose midis ish-bashkëshortëve ose partnerëve”.

Konventa e Stambollit synon të mbrojë dhe parandalojë gratë nga të gjitha format e dhunës dhe dhunës në familje, të promovojë barazinë gjinore, të propozojë strategji dhe masa për mbrojtjen dhe ndihmën ndaj viktimave, të promovojë bashkëpunimin ndërkombëtar në eliminimin e dhunës, të ofrojë mbështetje dhe ndihmë organizatave dhe agjencive qeveritare për të siguruar bashkëpunim efektiv.

Konventa gjithashtu kërkon që shtetet të sigurojnë që dhuna ndaj grave të konsiderohet vepër penale dhe që do të sanksionohet ashtu siç duhet dhe se trajtimi i dhunës si pjesë e zakoneve apo traditave kulturore të konsiderohet i papranueshëm. Shtetet duhet të sigurojnë që viktimat të kenë qasje në masat mbrojtëse gjatë hetimeve dhe procedurave gjyqësore dhe t'u garantohet asistencë dhe përgjigje adekuate për veprimet e organeve të zbatimit të ligjit.

Mund të përmendim se dokumentet e mësipërme ndërkombëtare tregojnë përpjekjet e OKB-së, Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës për të ruajtur të drejtat e njeriut dhe liritë themelore për të gjitha

¹² Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, Stamboll 11.V.2011, www.coe.int/conventionviolence.

grupet e njerëzve pa asnjë dallim. Është e rëndësishme që çështja e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje të diskutohet për të rritur ndërgjegjësimin sa më shumë të njerëzve. Në nivel ndërkombëtar, luftës kundër dhunës në familje dhe mbrojtjes së viktimave i kushtohet një vëmendje e madhe, por megjithatë mendoj se është e preferueshme që për këto tema të diskutohet edhe më shumë dhe të merren masa të tjera të përshtatshme për eliminimin maksimal të këtij fenomeni të rrezikshëm. Këto dokumente janë përfshirë në legjislacionin nacional, veçanërisht në formën e dispozitave të reja ligjore për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave. Gjithashtu, shtetet anëtare po trajtojnë këtë çështje duke hartuar plane kombëtare veprimi për të luftuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje.

Kuadri ligjor kombëtar për dhunën në familje

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut problemi i dhunës në familje e veçanërisht i dhunës ndaj grave, më herët nuk ka tërhequr vëmendjen shoqërisë, të institucioneve apo punëtorëve shkencor dhe profesional. Ky problem u aktualizua në vendin tonë në vitin 1994 me një vonesë prej të paktën dy dekadash e gjysmë.¹³

Kështu, në vitin 2004 dhuna në familje për herë të parë u inkriminua në Kodin Penal (KP) të Republikës së Maqedonisë, i cili braktisi pikëpamjen e mëparshme se dhuna në familje është çështje private. Dhuna në familje filloi të kuptohej jo vetëm si kërcënim ndaj personalitetit të viktimave, por edhe si kërcënim për shoqërinë në tërësi. Veprat penale kundër jetës dhe trupit janë të parapara në kreun XIV të Kodit Penal. Kur vepra është kryer gjatë dhunës në familje, parashihen sanksione të veçanta për këto vepra penale: Vrasja, neni 123, paragrafi 2, pika 2; Lëndimi trupor - neni 130 paragrafi 2 dhe lëndimi i rëndë trupor - neni 131 paragrafi 2. Sipas Kodit Penal është paraparë dënim më i rëndë me burgim prej së paku 10 vjet deri në burgim të përjetshëm, nëse privimi nga jeta kryhet gjatë ushtrimit të dhunës në familje për dallim nga forma bazike e veprës penale për të cilën është paraparë dënim prej së paku 5 vjetësh. Gjithashtu, neni 125 i Kodit Penal sanksionon "ai i cili do të privojë nga jeta në gjendje afekti, i sjellë pa fajin e tij, në gjendje të tronditjes së rëndë të shkaktuar nga sulmi apo fyerja e rëndë

¹³ Извештај од спроведено теренско истражување „Семејно насилство“, Здружение за еманципација, солидарност и еднаквост на жените во Република Македонија ЕСЕ, Скопје, 2000.

ose si pasojë e dhunës në familje nga ana e të vrarit, do të dënohet me burg nga një deri në tre vjet”.

Veçori e zgjidhjeve ekzistuese, si në legjislacionin civil ashtu edhe në atë penal, është përputhja e tyre me standardet dhe rekomandimet ndërkombëtare në këtë fushë, të cilat kërkojnë futjen e zgjidhjeve ligjore gjithëpërfshirëse, pra kriminalizimin e dhunës në familje dhe vendosjen e masave të përkohshme për mbrojtjen e viktimave. Kodi Penal e njeh dhunën seksuale si vepër penale por nuk parasheh sanksion të veçantë kur e njëjta është kryer në kuadër të dhunës në familje dhe me këtë i len një numër të konsiderueshëm viktimash jashtë sistemit të mbrojtjes nga dhuna seksuale. Praktikisht, rastet më të shpeshta të dhunës në familje i kemi: lëndimet trupore, vrasjen në afekt, dhunën, rrezikimin e sigurisë dhe dëmtimit të rëndë trupor etj. Dhuna seksuale është një nga format më të zakonshme të dhunës në vendin tonë, por në të njëjtën kohë një nga format më pak të raportuara. Deri më sot, dukuria e dhunës në familje është objekt i hulumtimit shkencor kushtuar përcaktimit të përhapjes, dinamikës, karakteristikave të dhunës në familje dhe përcaktimit të intensitetit të rrezikut të manifestuar të dhunës në familje ndaj grave, fëmijëve dhe të personave tjerë në gjini.

Me parashikimin e mbrojtjes juridike civile për viktimat e dhunës në familje, u vendos një sistem juridik për mbrojtje juridike të viktimave, së pari përmes ndryshimeve në dispozitat e **Ligjit për familje** (2004),¹⁴ pastaj me ndryshimet dhe plotësimet në **Ligjin për Mbrojtjen Sociale** (2004).¹⁵ Dhjetë vjet më vonë çështja e dhunës në familje u rregullua në mënyrë edhe më të detajuar përmes dispozitave të **Ligjit për parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje** (2014).¹⁶ Në 2021 u soll **Ligji i ri për pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhunës në familje**, i cili u soll pas Ligjit për parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen e dhunës në familje, i cili ishte ligji i parë sistematik në fushën e dhunës në familje. Me këtë Ligj rregullohen kompetencat e institucioneve me theks të veçantë marrja e masave për të parandaluar dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunën në familje, koordinimi i ndërsjellë i institucioneve dhe organizatave, shërbimeve për mbrojtjen e viktimave dhe mbledhjen e të dhënave për

¹⁴ Ligji për familje, Gazeta zyrtare e RMV-së, nr.80/1992, 9/1996, 38/2004, 33/2006, 84/2008, 67/2010, 156/2010, 39/2012 и 44/2012.

¹⁵ Ligjin për mbrojtje sociale, Gazeta zyrtare e RMV-së, nr. 65/2004.

¹⁶ Ligjit për parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, Gazeta zyrtare e RMV-së, nr. 138, datë 17.09.2014.

dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunën në familje.¹⁷ Qëllimi i ligjit është të parandalojë dhe pengojë dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunën në familje, mbrojtjen efektive të viktimave nga çdo formë e dhunës gjinore ndaj grave si dhe viktimave të dhunës në familje në lidhje me respektimin e lirive themelore të njeriut dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Qëllimi i ligjit bazohet në parimin e barazisë dhe eliminimin e stereotipave për rolet gjinore.¹⁸

Fokusin kryesor në Ligjin për Familje në aspektin e mbrojtjes nga dhuna në familje e kanë “Masat e përkohshme për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje”, të cilat synojnë mbrojtjen e drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme të viktimës. Në rastet e lëndimeve të rënda ose të vazhdueshme të incidenteve të shoqëruara me intensitet të shtuar, masat e përkohshme të mbrojtjes dhe ndjekjes penale së bashku mund të arrijnë rezultate më efikase.

Në Ligjin për familjen janë paraparë një sërë masash për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, përkatësisht masave të përkohshme mbrojtëse që mund t’i shqiptojë gjykata. Për moszbatimin e tyre nga ana e personit zyrtar apo personit të ngarkuar nga gjykata, është paraparë përgjegjësi penale.

Ofrimi i sigurisë dhe mbrojtja e viktimave nga dhuna e ardhshme, respektivisht ndihmën në tejkalimin e pasojave të dhunës së përjetuar, si dhe krijimin e kushteve për integrimin e saj në mjedisin social, paraqesin kushtet themelore që duhet të plotësuar gjatë marrjes së masave mbrojtëse. Zakonisht këto masa, përveç viktimës, nënkuptojnë edhe sigurimin dhe mbrojtjen e anëtarëve të tjerë të familjes, të cilët paraqiten në rolin e viktimave dytësore.

Masat e tilla mundësojnë plotësimin e llojeve të ndryshme të nevojave për mbrojtje, pavarësisht nëse ato janë të shqiptuara individualisht apo në mënyrë kumulative me masa tjera. Karakteristikë e veçantë e masave të tilla të përkohshme është ajo se ato sipas nevojës ofrojnë ndihmë të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme për viktimën sipas nevojës mund të kenë kufizues dhe imperativ.

¹⁷ Neni 1 i “Ligji të ri për pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhunës në familje”, Gazeta zyrtare e

RMV-së, nr. 24/2021, datë 29.01.2021.

¹⁸ Po aty, neni 2

Masat e përkohshme mbrojtëse në procesin e monitorimit të mëtejshëm të zbatimit të zgjidhjeve ligjore, veçanërisht në fushën e mbrojtjes nga dhuna në familje, mund të shqiptohen nga gjykata, Ministria e Punës dhe politikës sociale, shoqatat e qytetarëve që punojnë në këtë fushë dhe institucione të tjera relevante. Më saktësisht, me ndryshimet në Ligjin për Familjen në vitin 2006, u caktua mandati i ministrive përkatëse në pjesën e ekzekutimit të masave të mbrojtjes së përkohshme. Krahas këtyre ndryshimeve, me qëllim unifikimin dhe zbatimin gjithëpërfshirës të Ligjit, si dhe harmonizimin me standardet ndërkombëtare në këtë fushë, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, në bashkëpunim me organizatat përkatëse të shoqërisë civile, në vitin 2007 përgatiti një propozim për ndryshime të Ligjit për Familjen.

Në vitin 2007, për shkak të funksionalizimit të disa zgjidhjeve ligjore nga Ligji për Familjen dhe përmirësimit të akteve nënligjore, është nxjerrë një Rregullore për mënyrën e zbatimit dhe monitorimit të masave të shqiptuara për mbrojtjen e familjes dhe personave viktimë të dhunës në familje, të ndërmarra nga ana e Qendrës për punë sociale dhe për mënyrën dhe përcjelljen e masave të përkohshme të shqiptuara nga gjykata.

Me ndryshimet dhe plotësimet e fundit në vitin 2008, u arrit të sigurohet harmonizimi i përkufizimit të dhunës në familje me Kodin Penal; mundësia që shoqatat civile të sigurojnë masa për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje; detyrimin që të njoftohet Qendra kompetente për punë sociale nga të gjitha institucionet të cilat ndërmarrin veprime për mbrojtje nga dhuna në familje, në afat prej 72 orësh. Në të njëjtën kohë, ndryshimet i japin viktimës një mundësi shtesë, përveç në mënyrë indirekte përmes Qendrës për punë sociale, që të paraqesë propozim në gjykatë për caktimin e masës së përkohshme të mbrojtjes. Për dallim nga sistemi i mbrojtjes juridike-penale, mbrojtja juridike-civile e viktimave duhet të sigurojë siguri dhe mbrojtje të viktimave të dhunës për të ardhmen, si dhe të krijojë kushte për ndërveprimin e tyre në mjedisin social. Institucionet kompetente që zbatojnë sistemin juridik civil të mbrojtjes janë; Qendrat për punë sociale, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, institucionet arsimore, sektori joqeveritar dhe gjykata civile.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, korniza ligjore për mosdiskriminim dhe barazi përbëhet nga: Kushtetuta, ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara. Vlerat themelore të rendit tonë kushtetues janë: liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit të njohura nga e drejta ndërkombëtare dhe të përcaktuara me Kushtetutë. E

drejta për mosdiskriminim dhe barazi është e përfshirë në nenin 9 të Kushtetutës, i cili përmban liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit: “Qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë të barabartë në liritë dhe të drejtat, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, nga prejardhja kombëtare dhe sociale, nga bindjet politike dhe fetare, nga statusi pasuror dhe shoqëror”.

Pas ndryshimeve normative u krijua **Strategjia kombëtare për barazi dhe mosdiskriminim 2016-2020** që mbështet në “mbrojtjen efikase nga diskriminimi dhe respektimin e parimit të mundësive të barabarta dhe ndalimit të diskriminimit ndaj çdo personi dhe/ose grupi personash, bazuar në karakteristikat e tyre personale, veçanërisht të grupeve të prekura sociale”.¹⁹ Në këtë drejtim, **Strategjia për Barazi Gjimore 2013-2020** paraqet një dokument strategjik që ofron një kornizë normative për barazinë e plotë të grave dhe burrave, si një prioritet social dhe politik. Gjithashtu, ky dokument përcakton hapat bazë dhe udhëzimet specifike për arritjen e plotë të barazisë gjimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Dokumenti tjetër i rëndësishëm është **Strategjia Kombëtare për Barazi Gjimore 2021-2026**, me nxjerrjen e së cilës Republika e Maqedonisë së Veriut përpiqet të përmirësojë gjendjen e barazisë gjimore në përputhje me standardet, rekomandimet dhe detyrimet ndërkombëtare, duke pranuar se barazia gjimore është një nga aspektet kyçe për prosperitetin e të gjithë shoqërisë. Për të përmirësuar situatën me barazinë gjimore dhe për të fuqizuar gratë për kontributin e tyre të plotë në shoqëri, Qeveria e RMV-së, përcakton dhe zbaton strategji, programe, masa, zgjidhje ligjore dhe shërbime të caktuara. Me miratimin e këtij dokumenti, si kornizë e gjerë strategjike që bashkon të gjitha fushat e veprimit për arritjen e barazisë gjimore, Republika e Maqedonisë së Veriut, qartas fokusohet në integrimin e perspektivës gjimore në politikat dhe strategjitë, luftimin e stereotipeve dhe dhunës ndaj grave, avancimin e pozitës së gruas në të gjitha sferat e jetës publike dhe private dhe monitorimin e situatës me barazinë gjimore përmes të dhënave relevante.

¹⁹ Strategjia nacionale për barazi dhe mosdiskriminim 2016-2020, http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/dokumenti/7.7_Strategjia%20za%20ednakvost%20i%20nediskriminacija.pdf

Conclusion

The Republic of North Macedonia, as a member state of the United Nations (UN) and the Council of Europe, has acceded to the most important international and regional agreements for the protection of human rights. Most of these agreements/treaties, either directly or through the inclusion of their provisions in national legislation, have become part of positive law. As the most relevant document in the international aspect that deals with the issue of violence against women and domestic violence is The Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence, otherwise known as the Istanbul Convention. The Republic of North Macedonia signed the Istanbul Convention in 2011, while ratification followed seven years later, demonstrating the country's political will to address the issue of domestic violence. However, for the provisions of the Convention to be implemented, it was necessary to harmonize domestic legislation with the commitments of the Convention. All previous documents issued internationally, have undoubtedly affected the regional systems for the protection of human rights, as well as in our country. Effective fight against violence against women and domestic violence requires not only good knowledge of international standards, but also continuous monitoring and implementation of national legislation. To improve the situation with gender equality and to empower women for their full contribution to society, the Government of the RMV defines and implements certain strategies, programs, measures, legal solutions and services. All these strategies are expected to have an effect on combating stereotypes and violence against women, advancing the position of women in all spheres of public and private life and monitoring the situation with gender equality through relevant data.

Recensentë:

Prof. dr. Arta Bilalli

Doc. dr. Irma Bajrami

Literatura

1. 2263 (XXII). Declaration on the Elimination of Discrimination against Women, http://www.eods.eu/library/UNGA_Declaration%20Women_1967_en.pdf
2. Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women New York, 18 December 1979, <https://web.archive>.

org/web/20150507222247/http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CEDAW.aspx

3. Convention on the Rights of the Child. New York 20 November 1989, https://treaties.un.org/doc/Treaties/1990/09/19900902%2003-14%20AM/Ch_IV_11p.pdf

4. Council of Europe. (1950). Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms. In *Council of Europe Treaty Series 005*. Council of Europe.

5. GENERAL RECOMMENDATIONS ADOPTED BY THE COMMITTEE ON THE ELIMINATION OF DISCRIMINATION AGAINST WOMEN, Eighth session (1989)*, General recommendation No. 12: Violence against women, <https://www.ohchr.org/en/hrbodies/cedaw/pages/recommendations.aspx>

6. GENERAL RECOMMENDATIONS ADOPTED BY THE COMMITTEE ON THE ELIMINATION OF DISCRIMINATION AGAINST WOMEN, Eleventh session (1992)**, General recommendation No. 19: Violence against women, <https://www.ohchr.org/en/hrbodies/cedaw/pages/recommendations.aspx>

7. Millennium Development Goals (MDGs), United Nations, 1990.

8. United Nations (General Assembly). (1966). International Covenant on Civil and Political Rights. *Treaty Series*, 999, 171.

9. United Nations, Beijing Declaration and Platform of Action, adopted at the Fourth World Conference on Women, 27 October 1995, available at: <https://www.refworld.org/docid/3dde04324.html>

10. United Nations. (1948). *Universal Declaration of Human Rights*.

11. Ligji për familje (Gazeta zyrtare e RMV-së, nr.80/1992, 9/1996, 38/2004, 33/2006, 84/2008, 67/2010, 156/2010, 39/2012 и 44/2012).

12. Ligji për parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, Gazeta zyrtare e RMV-së, nr. 07- 3478/1, 15 shtator 2014.

13. Ligji për pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhunës në familje, Gazeta zyrtare e RMV-së, nr: 24/2021 од 29.01.2021.

14. Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, Stamboll, 11.V.2011, www.coe.int/conventionviolence.

15. Strategjia nacionale për barazi dhe mosdiskriminim 2016-2020, http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/dokumenti/7.7_Strategjia%20za%20ednakvost%20i%20nediskriminacija.pdf